



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 526 prot.

Gjirokastër më, 27.05.2020

MIRATOHET

PREFEKTI

Astrit ALIAJ



PLAN - MASASH

“MBI MASAT E MARA NË PARANDALIMIN, MBROJTJEN DHE PËRGJIGJEN NDAJ SITUATAVE TË MUNDSHME TË EMERGJENCAVE NGA ZJARRET NË PYJE DHE KULLOTA GJATË STINËS SË VERËS PËR VITIN 2020”.

Baza ligjore

1. Ligji nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8,14.
2. Ligji nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”.
3. VKM nr. 835, datë 03.12.2004, “Plani Kombëtar për Emergjencat Civile”.

4. Ligji nr. 108/ 2014 “Për Policinë e Shtetit”, neni 76.
5. Ligji nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, neni 9.
6. Udhëzimi nr. 16, datë 11.07.2003, “Për ngritjen e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në nivel qarku”.
7. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
8. Vendimi nr. 965, datë 02.12.2015, “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”.

Të përgjithshme

Sezoni i stinës së verës dhe vjeshtës në territorin e Qarkun Gjirokastrë, krahas zbatimit të VKM nr. 236, datë 19.03.2020, “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” dhe në zbatim të detyrimeve ligjore dhe planit të veprimit të Prefektit të qarkut në situatën e krijuar, paraqet probleme të veçanta si pasojë e:

- Kritjes së temperaturave të larta për një periudhë të gjatë, që ndryshon situatën në pyje dhe kullota, pemëtari, në zona rurale dhe urbane.
- Mbipopullimit të sezonit të verës, (sezoni turistik).
- Neglizhencës së sjelljes dhe reagimit ndaj rreziqeve nga temperaturat e larta.

Pyjet dhe kullotat në territorin e Qarkut të Gjirokastrës, zënë një sipërfaqe si më poshtë:

- Bashkia Gjirokastrë:	Sipërfaqe pyjore	rreth	9411.3 ha	dhe	kullota 12602 ha.
- Bashkia Dropull:	Sipërfaqe pyjore	rreth	10058.7 ha	dhe	kullota 12894.7 ha.
- Bashkia Libohovë:	Sipërfaqe pyjore	rreth	886.1 ha	dhe	kullota 2587.9 ha.
- Bashkia Tepelenë:	Sipërfaqe pyjore	rreth	9584 ha	dhe	kullota 20524 ha.
- Bashkia Memaliaj:	Sipërfaqe pyjore	rreth	8614.8 ha	dhe	kullota 4896.2 ha.
- Bashkia Këlcyrë:	Sipërfaqe pyjore	rreth	6918 ha	dhe	kullota 9165 ha.
- Bashkia Përmet:	Sipërfaqe pyjore	rreth	10603.3 ha	dhe	kullota 7107.3 ha.

- Parku kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”, bashkia Përmet: Zë një sipërfaqe pyjore rreth 17401.3 ha dhe kullota 4776 ha. (Brenda këtij parku ndodhen 1706 ha sipërfaqe pyjore private).
- “Bredhi i Sotirës”, bashkia Dropull: Zë një sipërfaqe pyjore rreth 1600 ha dhe (sipërfaqe kullosore nuk ka).

- “Bredhi i Kardhiqit”, bashkia Gjirokastrë: Zë një sipërfaqe pyjore rreth 1600 ha dhe kullota 200 ha.
- Parku natyror “Zagori”, bashkia Libohovë: Zë një sipërfaqe pyjore rreth 49121 ha dhe kullota 9433 ha.

Mos menazhimi i mirë i këtyre pasurive, ka bërë që gjatë sezonit të verës të vitit 2019, ka patur vatra dhe provokime zjarresh në shumë raste. Numri i zjarreve nga shkaqe natyrore është shumë i vogël. Rastet e zjarreve janë pothuajse të gjithë nga ndërhyrje njerëzore qoftë aksidentale ose me dashje.

Në qarkun tonë, ka pasur raste të shumta zjarresh të qëllimshme, për përfitimin e kullotave duke kërcënuar dhe zona të mbrojtura me vlera kombëtare.

Marrja shpejt e sinjalit për zjarr dhe koordinimi i veprimeve, mbeten clemente kyç për fikjen shpejt dhe uljen e kostos së tyre (zjarreve).

Në drejtim të parapërgatitjes, parandalimit, mbrojtjes dhe përgjigjes ndaj situatave që mund të krijohen gjatë kësaj vere nga zjarret në pyje dhe kullota, të zbatohet Plani i Masave të hartuar, puna e të cilit përqëndrohet në drejtimet e më poshtme:


NR	MASAT QË DO TË MERREN DHE ZBATOHEN	AFATI	ZBATUESI
I.	PËR INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT		
1.	Organizimin dhe zhvillimin e mbledhjes së Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku për parapërgatitjen, parandalimin, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave të mundshme të emergjencave civile nga zjarret në pyje dhe kullota gjatë stinës së verës.	10 Qershor 2020	Prefekti i Qarkut
2.	Kontrollin e punës me strukturat përgjegjëse të emergjencave civile dhe me ato të vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave parandaluese për përballimin e situatave gjatë stinës së verës.	Në vazhdimësi	Prefekti i Qarkut
II.	PËR INSTITUCIONET DHE NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE		
3.	Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore të organizojnë takime me komunitetin, administratorët e njërive vendore, kryetarët e fshatrave, personat që shfrytëzojnë pyjet dhe kullotat sipas kontratave të lidhura, sensibilizimin e tyre, njohjen e legjislacionit, penalteteve për zjarrvëniet e qëllimshme dhe pakujdesitë, të cilat sjellin shfaqjen e zjarreve në pyje dhe kullota.	1-15 Qershor	D.V.P. Qarkut, Nj.e Vetëqeverisjes Vendore, S.E. Bujqësor, S. E.C. Krizave
	Në zbatim të ligjit nr. 2018/2014 “Për Policinë e Shtetit” nga çdo komisarjat të përpilohen Plan -		DVP së Qarkut,

4.	Masash për marrjen e masave konkrete në garantimin e rendit dhe sigurisë publike nga rreziqet që mund t'i kanosen jetës së njeriut dhe pronës nga rënia e zjarreve në pyje dhe kullota etj.	Në vazhdimësi	Nj.e Vetëqeverisjes Vendore
5.	Të përpilohen plane masash të përbashkëta me detyrat konkrete për koordinimin e veprimeve të forcave operuese, intesifikimin e ushtrimit të kontrolleve të zonave pyjore dhe kullota me rrezikshmëri të lartë, në marrjen e masave parandaluese ndaj rënieve të zjarreve, gatishmërisë së personelit, mjeteve dhe pajisjeve për shuarjen e tyre. Institucionet përkatëse të hartojnë plan-kalendar me grafik, për organizimin e takimeve sensibilizuese me banorët, administratorët e njësive, punonjës të blegtorisë, forcat vullnetare etj.	Në vazhdimësi	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, I.Sh.M.Pyjeve, A. Z. Mbrojtura
6.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me Drejtoritë e Shëndetit Publik duhet të kenë në vëmendjen e tyre marrjen e masave për ngritjen e shërbimit të emergjencës shëndetësore pranë zonave turistike, gatishmërinë e hidranteve të furnizimit me ujë të mjeteve zjarrfikse etj., deri në mbylljen e sezonit turistik. Në rastet e fluksit të madh të emigrantëve në Pikën Kufitare Kakavije, të merren masa të stacionimit të një mjeti autoambulancë me personel shëndetësor në periudhën e stinës së verës.	Në vazhdimësi	Nj.e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtoritë e Shëndetit Publik
7.	Organizimin e takimeve periodike të Komisionit Vendor të Mbrojtjes Civile (Shtabeve të Emergjencave Civile), të institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore me objekt analizimin e situatave që mund të krijohen nga rëniet e zjarreve, marrjen e masave në sezonin e verës, përgjegjësitë institucionale duke ju referuar detyrimit ligjor.	Në vazhdimësi	Nj.e Vetëqeverisjes Vendore, I.Sh.M.Pyjeve, A. Z. Mbrojtura
8.	Nëpërmjet strukturave përkatëse, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe në veçanti strukturat e Shërbimit Pyjor (<i>Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Administrata e Zonave të Mbrojtura</i>), për ruajtjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave, në zonat më problematike apo në çdo njësi administrative, të organizohen dhe të inspektohen në vend marrja e masave për ngritjen e grupeve vullnetare dhe të vrojtuesve sezonalë në çdo fshat, për zbulimin, evidentimin dhe njoftimin në kohë të çdo vatre zjarri të mundshëm.	Në vazhdimësi	Nj.e Vetëqeverisjes Vendore, I.Sh.M.Pyjeve, A. Z. Mbrojtura
9.	Të evidentohen nga administratorët lokalë, fermerët që kanë plantacione frutikulture, nga rreziku i zjarreve që mund të krijohen gjatë stinës së verës. Të evidentohen blektorët dhe zonat e patronazhit në pyje dhe kullota, tërheqje e vëmendjes dhe kujdesi në parandalimin e zjarreve.	Në vazhdimësi	Nj.e Vetëqeverisjes Vendore, S.E.Bujqësor

10.	Të evidentohen, kontrollohen dhe të vihen në gatishmëri nga gjithë institucionet që disponohen kapacitete njerëzore, automjete dhe pajisje zjarrfikëse, në përballimin e situatave të rënies së zjarreve në pyje dhe kullota gjatë stinës së verës.	Në vazhdimësi	Stacionet e MZSH-ve, I.Sh.M.Pyjeve, A. Z. Mbrojtura
11.	Të organizohen takime me Komandën e Detashmentit të Mbështetjes Rajonale, stacionet e MZSH-ve, shërbimin pyjor (<i>Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Administrata e Zonave të Mbrojtura</i>), për parapërgatitjen dhe organizimin e punës së strukturave përkatëse lokale, në intesifikimin e masave mbrojtëse kundër rrezikut të rënies së zjarreve gjatë stinës së verës.	Në vazhdimësi	KDMRajonale, I.Sh.M.Pyjeve, A. Z. Mbrojtura, Stacionet e MZSH-ve
12.	Çdo Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga rreziku i zjarreve në stinën e verës, të marrë masa për sensibilizimin e opinionit publik me të gjitha mjetet e komunikimit të mediave lokale, shpërndarjen e fletë - palosjeve etj., (<i>destinacioni rritja e sensibilizimit të banorëve të zonave rurale, zonave turistike, fermerëve, bizneseve, blegtorëve, të nxënësve etj.</i>).	Në vazhdimësi	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
13.	Nga çdo Njësi e Vetëqeverisjes Vendore të përcaktohen vëndfurnizimet me ujë të mjeteve ajrore që mund të përdoren për shuarjen e zjarreve (Kordinatat).	10 Qershor 2020	Nj. e Vetëqeverisjes Vendore
14.	Nga çdo Njësi e Vetëqeverisjes Vendore të merren masa për vënien në gatishmëri për ndërhyrje në rast nevojë, kapacitetet e tyre, strukturat e MZSH-së, të ndërmarrjeve që ato kanë në varësi, si Ujësjellës Kanalizime sh.a. etj., me qëllim furnizimin e popullatës në ato raste kur mungon uji i pijshëm.	Në vazhdimësi	Nj. e Vetëqeverisjes Vendore, D.U.K sh.a.
15.	Të ngrihen nga çdo Njësi të Vetëqeverisjes Vendore grupet e konstatimit dhe të vlerësimit të dëmeve që mund të shkaktohen nga zjarret gjatë stinës së verës.	Në vazhdimësi	Nj. Vetëqeverisjes Vendore

Spektori i Emergjencave Civile dhe Krizave Vendore

Përgjegjësi


Thoma KOTI